



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:197038

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05080386

PPP. nr. 16/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit SH.A, K..., kundër debitorit B.Th nga Gllogoci, lidhur me borxhin në shumën prej 1447.86 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori B.Th, kundër Urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit privat I.M, P.nr... të datës 25.01.2018, jashtë seance me datë 18.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit B.Th nga Gllogoci.
- II. OBLIGOHET** debitori B.Th, nga Gllogoci, që në emër të borxhit të pa paguar për energjinë elektrike të shpenzuar për periudhën kohore nga **data 08.01.2016 deri me datën 05.01.2018** të ia paguaj Kreditorit shumën prej **450.65 €** me kamatë ligjore në lartësi 8% në vit duke filluar nga pranimi i këtij vendimi gjer në pagesën definitive të detyrimit me kamatë ligjore prej 8% në vit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.
- III. SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhëri mbi lejimin e Përmbarimit P. nr... të datës 25.01.2018 për periudhën kohore nga data 03.04.2014 e deri me datën 08.12.2015 në shumën prej **997,21 €** për shkak të parashkrimit të kërkesës/borxhit.

A r s y e t i m

Kreditori Sh.A, K... ka parashtruar propozimi te Përmbaruesi Privat I.M nga Prishtina për lejimin e përmbarimit në bazë të Ekstraktit nga Librat Afaristë, kundër debitorit B.Th nga Gllogoci, lidhur me pagesën e borxhit për tatimin në pronë në shumën prej 1447.86 Euro, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbaruesi Privat I.M, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të **Ekstraktit nga Librat Afariste** – me shenjën DPR...

Debitori B.Th ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor me arsyetimin se nuk ka dëshmi se faturat janë dorëzuar me rregull te debitori si dhe borxhi për të cilën është paraqitur propozimi për përmbarim është parashkruar në bazë të Nenit 360 par. 1.1 të LMD-së, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 1 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhri P. nr... të datës 25.01.2018 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si pjesërisht të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – Ekstraktin të lartëcekura për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me Urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga këto ekstrakte si në rastin konkret.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në Nenin 360 par.1 pika 1.1 ku thotë: *Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, e në rastin konkret borxhi nga periudha prej datës 03.04.2014 e deri me datën 08.12.2015 është parashkruar pasi që ka kaluar afati ligjor mbi parashkrimin.*

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmban dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 29, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm – **ekstraktet** nga të cilat shihet se debitori ia ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj Kreditorit pasi që ka parashkrim të borxhit në bazë të Nenit 360 par.1 pika 1.1, dhe se faturat nuk janë dorëzuar me rregull. Gjykata lidhur me parashkrimin pjesërisht e aprovoj, ndërsa kreditori në anën tjetër, propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur ekstraktet e vërtetuara të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i besueshëm në kuptim të Nenit 29 par. 1.2 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar pjesërisht Urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P. Nr... të datës 25.01.2018, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.16/18, datë 18.12.2023**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.